REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 123/17
Date/Datum 08.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEÈ

PSH. Nr. 123/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Tefik Sylejmani - Kryetar, z. Goran Milenkoviq – Referues dhe Blerim Dina –anëtar,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Europrinty"Shpk nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me tonera për nevojat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit:2242/17/45/111 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës, më: 30.05.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **Aprovohet**, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE ankues"Europrinty"Shpk nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me tonerë për nevojat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit:2242/17/45/111 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës.

II.Vërtetohet vendimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me tonerë për nevojat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. të prokurimit:2242/17/45/111.

III.Atorizohet autoriteti kontraktues – Universiteti i Prishtinës të vazhdoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-ës të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues,që nuk respekton vendimin e panelit shqyrtues të paraparë me këtë ligj

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Limit&B" - Prishtinë janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, ju kthehet sigurimi i ankesës.OE në afat prej 60 ditësh janë të obliguar të parashtrojnë kërkesë për tërheqjen e mjeteve në të kundërtën këto mjete barten në buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës ka bërë njoftimin për kontratë me emrin "Furnizim me tonera për nevoja të Universitetit të Prishtinës,"Hasan Prishtina", me numër të prokurimit 2242/17/45/111. Njoftimi është bërë me datë 30.01.2017 në faqe të KRPP-së, procedurë e hapur, kontratë për furnizim, me vlerë të madhe, vlera paraparë 400.000€.

Kriter ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, afati për ofertim ka qenë 10.03.2017, njoftimi për dhënie të kontratës ka qenë 11.04.2017.

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë 6 OE.

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën me 03.04.2017, ku kanë rekomanduar për kontratë OE:"Rikon" nga Prishtina me çmim 380,246.21€.

Kundër këtij njoftimi në OSHP ka parashtruar ankesë OE:"Europrinty", i cili pretendon se AK ka shkel nenin 7, 54, 60 të LPP-së.

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues z.Bibaj i cli ka dhënë mendimin e vet në ekspertizë i cili ka rekomanduar që ankesa të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të anulohet, dhe nëse AK ka interes lëndën ta kthej në Ritender.

OE është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ndërsa AK nuk janë pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me dt.30.05.2017 ku të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i AK,përfaqësuesi i OE ankues si dhe eksperti shqyrtues i prokurimit,shqyrtoi shkresat e lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues si dhe bëri dëgjimin e palëve ku në fillim fjala iu dha përfaqësuesit të OE ankues"Europrinty" znj.Gashi e cila deklaroj:

Ne qëndrojmë në tërësi pranë ankesës datës 21.04.2017 dhe ne si OE ankues pajtohemi me mendimin ekspertit shqyrtues siç kemi potencuar në përgjigjen tonë në ekspertizë.

Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të ketë parasysh ankesën tonë dhe mendimin e ekspertit dhe të anuloj këtë aktivitet të prokurimit.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-UP Hasan Prishtina z.Bajraktari i cili deklaroj:

Eksperti shqyrtues është bazuar për anulim në një pikë që nuk ka qenë fare pikë ankimore OE ankues.

Eksperti është bazuar te gjendja ekonomike financiare ku janë kërkuar me kontrata qarkullimi, mirëpo sipas LPP neni 108 për këtë pretendim të ekspertit ankuesi ka pas kohën për të bërë ankesë sipas nenit 108 pika 3.1 të LPP-ës.

OE ankues ka pas afat për ankesë në specifika dhe njoftim për kontratë, dhe këto duhet të cek se njoftimi për kontratë dhe specifikat mbahen 4 ditë në KRPP ku KRPP kontrollon gjitha kërkesat dhe në qoftë se ka ndonjë kërkesë jo kofnrom ligjit KRPP nuk bënë njoftimin për kontratë.

Ne nuk kemi pas asnjë kërkesë nga KRPP për përmirësim të kërkesave, njoftimi është publikuar , afati ka qenë 40 ditë, dhe mendojmë se çdo OE në rastin konkret edhe OE ankues ka pas kohë të mjaftueshme për të bërë kërkesa për sqarim, ose ankesë te AK.

Pala ankuese nuk ka shfrytëzuar këtë drejtë, dhe momentin e hapjes së ofertave pala ka hupë drejtën për të bërë ankesë kundër njoftimit të kontratës dhe kritereve të dosjes.

OE ankues ka bërë ankesë në për rishqyrtim pranë AK-së, mirëpo ky nuk ka qenë pretendim

ankimorë as pranë AK-së po as në ankesë pranë OSHP-së.

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK se a ka plotësuar OE kërkesën për kapacitet teknik-financiarë për 600.000€ në furnizime me tonerë.

Në përgjigje z.Bajrakatari deklaroj:

Ne kemi kërkuar vlerën 600.000€ me kontrata për vitet 2014-2015-2016.

OE ka dështuar me plotësuar këtë kërkesë sepse nuk ka sjell kontrata dhe qarkullim në këtë vlerë, ose ka sjell fatura të cilat nuk janë me kontrata dhe që nuk lidhen me kontratat të cilat i ka në listë të kontratave.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Bibaj i cili deklaroj:

Pretendimet ankimore sipas përshkrimit në ankesë lidhen me arsyetimin e eliminimit të OE ankues. Sipas shkresave të lëndës letër standarde për eliminim nuk kam pas në lëndë, me gjithë atë i jam referuar vendimit të AK-së kundrejt kërkesës për rishqyrtim, ndërsa në arsyetimin e njëjtit vendim potencohet se AK nuk ka pas qarkullim me kontrata të përfunduara gjatë viteve 2014-2015-2016.

Kjo kërkesë sipas përshkrimit në dosje dhe njoftim për kontratë lidhet me kapacitetin ekonomik dhe financiarë, rrjedhimisht rezulton se kjo ka qenë pretendim ankimorë.

Arsyeja pse kam rekomanduar që ky aktivitet të anulohet lidhet pikërisht me kapacitetin ekonomik financiarë ku AK si dëshmi dokumentare ka kërkuar të dëshmohet me kopje të kontratave.

Pra një gjë e tillë nuk parashihet në ndonjërën nga dispozitat e nenit 68 që ka të bëjë me kapacitet ekomomik por kopjet e kontratave te kapaciteti teknik dhe profesional sipas nenit 69 të LPP-së.

Rrjedhimisht propozimi im ka qenë që ankesa të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE znj.Gashi deklaroj:

Qëndrojmë pranë ankesës dhe deklarimeve të bëra deri në tani.

Në fund përfaqësuesi i AK z.Bajraktari deklaroj:

Pretendimi ankimorë i OE ankues nuk është pse është vënë ky kriter dhe pse janë kërkuar kontrata, kjo është pretendim i ekspertit.

Përsëris edhe njëherë, faturat që ka ofruar OE ankues nuk kanë të bëjnë me listën e kontratave që ka pas në ofertë.

Paneli shqyrtues nga shkresat e lëndës dhe nga dëgjimi i palëve në seancën dëgjimore konstatoi se OE nuk ka parashtruar kërkesë,sqarim apo ankesë lidhur me kërkesat,specifikat apo kriteret e kualifikimit apo dhënies së kontratës në pajtim me LPP-ës dhe legjislacionin dytësor të prokurimit publik.

Nga shkresat e lëndë konfirmohet se OE ankues nuk ka dorëzuar-nuk ka plotësuar kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik dhe financiar pika III.2.2 të DT ku është kërkuar të dëshmoj se në tri vitet e fundit ka pas qarkullim me kontrata të përfunduara në vlerë prej 600,000.00 euro për furnizim me tonerë lidhur me këtë kjo u vërtetua edhe gjatë seancës dëgjimore se i njëjti ka dorëzuar fatura dhe jo kontrata të përfunduara edhe eksperti shqyrtues në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar se OE ankues ka plotësuar këtë kërkesë vetëm në vlerën prej 306,296.90 euro ndërsa pjesën tjetër e ka plotësuar me fatura.

Lidhur me shkelje të nenit 54 ashtu siç pretendon OE ankues nga ana e AK ky pretendim qëndron sepse AK nuk e ka njoftuar lidhur me eliminimin e këtij OE në pajtim me dispozitat LPP-ës.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi

themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues gjeti se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 7,60 dhe 69 të LPP-ës.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA